



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 4035/5 Prot

Tiranë 21.8.2026

Lënda: Shpallje për subjektin LUNA GROUP ALBANIA, me NIPT M51707042E

DREJTUAR: SUBJEKTIT LUNA GROUP ALBANIA, ME NIPT M51707042E

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Tiranë, ka kryer inspektim në subjektin Luna Group Albania, me nipt M51707042E, me adresë objekti me nr.pasurie 484/7, vol.9, ZK2704, Zip 1054, Mjull Bathore, Tiranë dhe gjatë procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, janë ndërmarrë aktet e inspektimit Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente me nr.ISHPSHSH-TR-2026-003615-4, datë 03.08.2026 dhe Procesverbal Inspektimi nr.ISHPSHSH-TR-2026-003615-2, datë 03.08.2026.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji 99, datë 12.09.2024 “Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë“ njoftimi i subjektit për këto akte nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë.

Bazuar në nenin 162 i Ligjit Nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH Tiranë ka vendosur njoftimin e subjektit Luna Group Albania, me nipt M51707042E dhe adresë objekti me nr.pasurie 484/7, vol.9, ZK2704, Zip 1054, Mjull Bathore, Tiranë për njohjen më këto akte inspektimi me anë të shpalljes së këtij njoftimi duke e afishuar në zyrat e Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë me adresë Rr. “Sheh Ahmet Pazari”; në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim; në QKB; në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web të ISHPSHSH-së.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Vendimit të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente, subjekti "Luna Group Albania" ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë. Pas njohjes me Procesverbalin e inspektimit, subjekti ka të drejtën të paraqesi kontesime me shkrim ose me gojë brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit.

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të dokumentacionit të inspektimit cituar sa më sipër dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë me adresë Rr. “Sheh Ahmet Pazari”, Tiranë.

Ky njoftim shpallet sot më datë 20.08.2026 do të qëndrojë i afishuar deri në datë 31.08.2026 në mjediset e ISHPSHSH-së në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim.

KRYEINSPEKTORI RAJONAL
Ardit Shabanaj

NË MUNGESË ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI
Armando Loga

